

VENDIM
Nr. 769, datë 12.12.2022

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1145, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT ARSIMOR SHKOLLA 9-VJEÇARE ‘HAJDAR ZOGU’, FSHATI TAPIZË, NJËSIA ADMINISTRATIVE NIKËL, BASHKIA KRUIJË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KRUIJË SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 1145, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, për financimin e rindërtimit të objektit arsimor, shkolla 9-vjeçare “Hajdar Zogu”, fshati Tapizë, Njësia Administrative Nikël, Bashkia Krujë, të jetë në vlerën 82 365 162 (tetëdhjetë e dy milionë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH dhe të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku